



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:070540  
Datë: 28.08.2024  
Numri i dokumentit: 06095314

**PAKR.nr.223/2024**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**-Departamenti i Krimeve të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Afërdita Bytyçi - Kryetare e kolegjit, Vaton Durguti dhe Skender Çoçaj - anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Gresë Latifi, në çështjen penale kundër të akuzuarit I.K nga fshati, Livoq i Poshtëm, Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale Keqpërdorim i detyrës zyrtare apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1. të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti i Krimeve të Rënda, e paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.230/2022 të datës 16.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPK-së, me datë 19.04.2024 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan – Departamenti i Krimeve të Rënda, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.230/2022 të datës 16.02.2024, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.230/2022 të datës 16.02.2024, të akuzuarin I.K konform nenit 363 paragrafi 1 nën

paragrafi 1.3 të Kodit të Procedurës Penale e ka liruar nga akuza pasi që nuk është provuar se i njëjti ka kryer veprën penale Keqpërdorim i detyrës zyrtare apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1. të KPRK-së.

Të dëmtuarat: K.G dhe M.Sh, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, janë udhëzuar në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës penale kanë rënë në barrë të mjeteve buxhetore të KGJK-së.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar:

Prokuroria Themelore në Gjilan - Departamenti i Krimeve të Rënda për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe aktgjykimin e ankimuar ta anuloj dhe lëndën ta kthej në rigjykim dhe rivendosje apo të njëjtin aktgjykim ta ndryshoj ashtu që i akuzuari të shpallet fajtor dhe t'i shqiptoj një sanksion penal meritor të paraparë me Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit I.K av. K.I.me propozim që Gjykata e Apelit të refuzon ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Prokuroria e Apelit me parashtresën, PPA/I.nr.209/2024, datë 08.04.2024 ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan – Departamenti i Krimeve të Rënda të aprovohet ashtu që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe lënda të kthehet te gjykata e shkallës së parë për rigjykim dhe rivendosje ose të ndryshohet aktgjykimi dhe i akuzuari I.K të shpallet fajtor dhe të njëjtit ti shqiptohet sanksion penal meritor i paraparë me Kodin Penal të Republikës së Kosovës ndërsa të refuzohet përgjigja në ankesën e PTH-së e parashtruar nga mbrojtësi i të akuzuarit I.K av. K.I. si e pabazuar.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPRK-së, në të cilën kanë prezantuar i akuzuari I.K, mbrojtësi i të akuzuarit sipas autorizimit zëvendësues av. SH.I. ndërsa nuk ka prezantuar Prokurori i Apelit i cili ka qenë i njoftuar me rregull për ditën dhe kohën e mbajtjes së seancës.

Gjykata e Apelit e Kosovës mbajti seancën e kolegjit gjyqësor dhe shqyrtoi shkresat e lëndës, gjithashtu vlerësoi aktgjykimin e kundërshtuar dhe pas vlerësimit të pretendimeve në ankesë gjeti se: **Ankesa është e pabazuar.**

### **Pretendimet ankimore**

Në ankesë Prokuroria Themelore në Gjilan pretendon se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 383 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 lidhur me nenin 384 paragrafi 2 nën paragrafi 2.7 të KPP-së. Aktgjykimi i atakuar është marrë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, kjo pasi ai nuk është i përpiluar konform nenit 369 të KPP-së, paragrafët 6,7, 10 kjo shihet qartazi në pjesën e arsytimit të vendimit i cili edhe pse është 15 faqe, në të kemi vetëm përshkrim të provave materiale, deklaratave të dëshmitarëve si dhe fjalët përfundimtare të palëve, por që në asnjë pikë të tij nuk është arsyetuar se përse gjykata ka vendosur si në dispozitiv të vendimit, përkundër që një gjë të tillë e kërkojnë dispozitat pozitive, e që përpilimi jo i rregullt i aktgjykimit paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe njëherësh paraqet shkak thelbësor për prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes në rivendosje. Gjykata gjithashtu, në mënyrë të veçantë në vendim duhet të vlerësoj saktësinë e provave kundërtënëse dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit, si dhe me rastin e zbatimit të dispozitave të caktuara të ligjit penal ndaj të akuzuarit dhe veprës së tij, ndërsa në rastin konkret aktgjykimi i atakuar nuk përmban arsyetim të plotë lidhur me atë çfarë është vendosur në dispozitiv. Gjithashtu gjykata në arsytimin e vendimit të saj do të duhej të shpjegonte se cilave prova i ka falur besimin dhe cilave jo, si dhe të shpjegonte arsyet se përse i është falur besimi provave të caktuara dhe përse provave tjera nuk i është falur besimi, ndërsa në aktgjykimin e atakuar, respektivisht në arsytimin e tij, gjykata në asnjë pikë të vetme nuk ka shpjeguar se cilave prova i ka falur besimin dhe përse e ka bërë një gjë të tillë. Arsyetimi i vendimit si pjesë përbërëse dhe funksionale e aktgjykimit duhet të përmbaj tipare që e bëjnë të qëndrueshëm aktgjykimin, e që në fakt këtij aktgjykimi i mungojnë këto tipare siç janë: qartësia, saktësia, konciziteti dhe komponenta analitike, e që në parim aktgjykimi konstaton faktet e çështjes e që në rastin konkret janë vlerësuar jo drejtë. Arsyetimi i vendimit dominohet nga përshkrimet e deklaratave të palëve, ekspertizave dhe provave dhe nuk ka një strukturë të caktuar ligjore dhe logjike në mënyrë që të bëj të mundur paraqitjen dhe shqyrtimin në mënyrë të duhur si nga aspekti kronologjik, faktik ashtu edhe ligjor i pretendimeve të palëve, duke shpjeguar pse dhe si është arritur në përfundimin

për të cilën është vendosur nga Gjykata. Gjykata e shkallës së parë, nuk ka vlerësuar as saktësinë e provave të paraqitura në aktin akuzues e posaçërisht dëshminë e dëshmitarit A.A i cili gjatë shqyrtimit gjyqësor në mënyrë të qartë ka deklaruar se ka monitoruar realizimin e projektit të Q.... - në G..., i autorizuar nga M.Sh, duke potencuar se fillimi i punimeve është bërë pasi që janë eliminuar pengesat lidhur me gypin e kanalizimit, probleme këto të paraqitura pas lidhjes së kontratës, dhe se pas kompletimit të gjithë dokumentacionit, pagesa i është kryer brenda dy jave në vlerë prej 1..... euro dhe se nuk ka pasur asnjëherë probleme me pagesa pasi që ministria e ka pasur buxhetin e siguruar. Dhe se operatori ekonomik nuk ka pasur arsye për shkëputje të kontratës dhe se kontrata bazë ka qenë 1..... euro, ndërsa kontrata e dytë për punët finale mbi 1..... euro. Gjykata e shkallës së I-rë, nuk e ka vërtetuar edhe gjendjen faktike pra, të njëjtën e ka vërtetuar gabimisht dhe jo në mënyrë të plotë në kuptim të nenit 386 të KPPRK. Aktgjykimin e kundërshtuar e bën të paqëndrueshëm edhe fakti se i njëjti është rrjedhojë e një vërtetimi jo të drejtë dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga të gjitha provat e lëndës rezulton se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë me aktin akuzues dhe se gjykata gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike dhe për këtë arsye gjykata fare nuk ka pasur të drejtë të akuzuarin t'a liroj nga aktakuza, pasi që gabimisht ka vërtetuar faktin se me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari I.K, ka kryer veprën penale e cila është ngarkuar sipas aktakuzës PP.99/2022 të datës 12.12.2022, e që një gjë e tillë mbështetet edhe në provat të cilat gjykata i ka administruar në shqyrtim gjyqësor, të cekura në aktgjykimin e atakuar të cilat gabimisht janë vlerësuar nga gjykata dhe ka përfunduar me një vendim të tillë edhe përkundër faktit se aktakuza ka qenë e mbështetur në prova të mjaftueshme, për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se i akuzuari I.K, ka kryer veprën penale e cila i ngarkohet sipas aktit akuzues. Tutje Prokuroria shton se gjatë deklaramit të vet përfaqësuesit të operatorit ekonomik, i njëjti tërë kohës ka deklaruar se ka pasur pengesa gjatë punimeve dhe janë shtyrë vazhdimisht punimet për shkak të pengesave të paraqitura dhe mos ekzekutimit të pagesave nga ana e Komunës, çka nënkupton se një gjë e tillë bie ndesh me deklaramin e vet përfaqësuesit të M.SH A.A dhe dëshmitarit S.A, të cilët kanë deklaruar se pagesat janë realizuar të gjitha dhe nuk ka pasur asnjë problem lidhur me pagesat, atëherë shtrohet pyetja se ku qëndron problemi i shkëputjes miqësore të kontratës dhe ku kanë shkuar shumat e parave të cilat janë ndarë për këtë projekt, nëse vetëm i dëmtuari Operatori Ekonomik A. CO, ka deklaruar se për shkak të mos pagesave e ka ndërprerë kontratën me K.G. Sa i përket çështjes së kompensimit të sigurimit të kontratës me polic të sigurimit në vlerë prej 1..... euro, e cila sipas nenit 22 të Draft kontratës, nuk ka pasur validitet për mbulim të tërë periudhës së kontratës pasi që nga Z.P (u.d. ka qenë i akuzuari) është dashur të kërkohet rinovimi i të njëjtës për dëmin e shkaktuar nga ana e kontraktuesit, fakte këto të cilave Gjykata fare nuk i

ka kushtuar rëndësi dhe ka marr një vendim jo meritor. Pastaj deklarata e dëshmitarit N.B, dhënë në Gjykatë, i cili ndër të tjera ka deklaruar se “ne nuk jemi dakorduar për shkëputjen e kontratës në rastin konkret dhe nga monitoruesi (A.A) kam kërkuar që kontrata të vazhdohet ashtu siç është lidhur, duke qenë se tek punët e vrazhda çmimet kanë qenë jashtëzakonisht të lira, ndërsa tek punët finale çmimet kanë qenë të papërgjegjshme e që në rastin konkret kërkesa e OE për ndërprerjen e punimeve është bërë kur janë përfunduar punimet e vrazhda, edhe përkundër vërejtjeve tona A.K e ka ndërprerë kontratën në mënyrë miqësore. Po ashtu është irrelevant konstatimi i Gjykatës kur ka konkluduar se “me asnjë provë nuk vërtetohet se i akuzuari I.K të kishte përfituar në mënyrë të kundërligjshme me rastin e shkëputjes së kontratës dhe se projekti më pas kishte përfunduar” sepse akti akuzues është ngritur për formën tjetër të keqpërdorimit shkaktimit të dëmit të personit tjetër, e në rastin konkret M.Sh dhe K.G, sepse kontrata për përfundimin e punëve në ndërtimin e QKMF në G. ka qenë 1..... .. € , dhe pas pagesave të bëra, përfshirë këtu edhe aneks kontratën është 5..... .. €, vlera e punëve të pakryera ka qenë ... .. € , ndërsa kur është ri tenderuar përsëri ndërtimi - pjesa e mbetur (finalizimi i punëve) i QKMF në G., për punët e mbetura kontrata ka qenë 1..... ..€ edhe pse llogaritet se kanë qenë të kryera rreth 45% të punëve në vlerë prej .... .. €, pra, ky është dëmtimi që pretendon Prokuroria puna që ka qenë dashur të kryhej për ..... ..€ në ri tenderim është paguar 1..... .. € , e që kjo vërtetohet me këtë provë materiale Ekspertizë financiare e dt..... e përpiluar nga eksperti financiar R.B, si dhe nga Plotësimi i ekspertizës financiare i përpiluar nga i njëjti ekspert e i kërkuar nga ana e Gjykatës i dt... .. , ku fq. 5 të pjesa Mendim dhe Konstatimi nën a) gjithsej dëmi i shkaktuar .... ..€, pra ekzistimi i provës së ligjshme, të besueshme dhe bindëse nuk ka mundur aq lehtë të anashkalohet nga Gjykata. Në rastin konkret, prokuroria konsideron se Gjykata gjatë vlerësimit të provave nuk u ka dhënë peshë të njëjtë të gjitha provave dhe dëshmive të shqyrtuara, ngase ajo nuk ka matur në mënyrë të njëjtë peshën e tyre për tu falur besimin sikurse atyre të dhëna në hetuesi, prokurori e më pas në shqyrtimin gjyqësor sepse të gjitha këto faza janë pjesë përbërëse e procedurës për të arritur deri tek e vërteta dhe gjykata është e obliguar që ti vlerësoj në mënyrë të njëjtë si provat fajësuese po ashtu edhe shfajësuese. Sipas Prokurorisë akti akuzues ndaj të akuzuarit I.K, ka ardhur si rezultat i gjendjes faktike që është krijuar gjatë hetimit dhe vlerësimit të provave, nga se Prokuroria nuk është për të ndëshkuar qytetarët pa të drejtë, por ajo përfaqëson shtetin në mënyrë të njëjtë dhe pa dallime për të gjithë qytetarët prandaj edhe vlerësimin e provave e bën si në favor e po ashtu edhe në dëm të personave të inkriminuar, e që në rastin konkret gjatë vlerësimit të tyre gjatë të gjitha fazave të procedurës është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se në veprimet e të akuzuarit I.K, janë përmbushur të gjitha elementet e veprave penale të cekura si më lartë.

## Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit pas analizimit të aktgjykimit të ankimuar, shkresave të lëndës si dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore gjeti se janë të pabazuara pretendimet ankimore përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga dispozita e nenit 384 të KPPRK-së, për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo gjykatë, e të cilat do të kishin kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të ankimuar. Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës vlerëson se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, meqenëse dispozitivi i aktgjykimit është i qartë dhe është në përputhshmëri të plotë me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, janë dhënë arsyet e duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje penale-juridike, duke vepruar kështu, konform dispozitës së nenit 369 par. 6 dhe 10 të KPP-së, ku gjykata e shkallës së parë ka paraqitur arsyet për çdo pikë të aktgjykimit, si ato faktike edhe ato juridike, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë.

Gjykata e shkallës së parë, ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta objektive, dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë, meqenëse me provat e administruara në shqyrtim gjyqësor nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar nga PTH-në Gjilan.

Sa i përket pretendimeve ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike të paraqitura nga Prokuroria Themelore në Gjilan, Gjykata e Apelit e Kosovës gjen se, gjykata e shkallës së parë edhe gjendjen faktike në këtë çështje penale e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për shkak se me provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor nuk është vërtetuar se i akuzuari I.K ka kryer veprën penale Keqpërdorim i detyrës zyrtare apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1. të KPRK-së, me ç ‘rast gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë duke marrë aktgjykim me të cilin të akuzuarin e ka liruar nga akuza, pasi që nga provat e administruara rezulton se në veprimet e të akuzuarit nuk përmbushen elementet e veprës penale Keqpërdorim i detyrës zyrtare apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1. të KPRK-së.

Kolegji penal i kësaj Gjykate, në këtë çështje penale vlerëson si të drejta përfundimet e shkallës së parë, e që deri tek kjo gjendje faktike gjykata e shkallës së parë ka ardhur pas administrimit të provave personale dhe materiale si:

Deklarata e dëshmitarit N.B, i cili ka deklaruar se ka qenë një marrëveshje mes M.Sh dhe K.G e lidhur me dt. ...., për bashkëfinancimin e projektit “ndërtimi i QKMF-së” në G., ku M.SH ka qenë investitor me 85%, e që kap shumën prej 1..... .. euro, derisa K.G, me 15 % të investimeve dhe në këtë marrëveshje ka qenë e paraparë që procedurat e prokurimit të udhëhiqen nga K.G. K.G ka lidhur kontratë për kryerjen e punimeve me operatorin ekonomik, në përputhje me marrëveshjen dhe se një mbikëqyrës - monitorues ka qenë nga M.SH. Lidhur me zbatimin e marrëveshjes janë diskutuar problemet që janë paraqitur në funksion të zbatimit të marrëveshjes, ashtu që monitoruesi nga MSH A.A na ka njoftuar se OE dëshiron ta shkëpusë kontratën me Komunën e Gj. në zbatim të mëtejshëm të projektit. Ne nuk jemi akorduar për shkëputjen e kontratës në rastin konkret dhe nga monitoruesi kam kërkuar që kontrata të vazhdohet ashtu siç është lidhur, duke qenë se tek punimet e vrazhda çmimet kanë qenë jashtëzakonisht të lira, ndërsa tek punët finale çmimet kanë qenë të papërgjegjshme. Pra, në rastin konkret kërkesa e OE për ndërprerjen e punimeve është bërë kur janë përfunduar punimet e vrazhda. Edhe përkundër vërejtjeve tona, AK e ka ndërprerë kontratën në mënyrë miqësore me OE, me dt.... .. M.SH-ja për të mos mbetur objekti i papërfunduar, ka propozuar që të plotësohet marrëveshja e bashkëpunimit dhe të finalizohet projekti. Sa i përket realizimit të pagesave nga M.SH për punët e kryera në fillim ka pasur defekte - pengesa, ngase nuk ka pasur një praktikë të mëhershme kur njëra palë në marrëveshje i kryen procedurat e prokurimit, e pala tjetër i realizon pagesat, por që më vonë nuk e di nëse ka pasur pengesa në ekzekutim të pagesave. Pagesat e gjithmbarshme për punët e kryera kanë qenë .... .. euro. Sa i përket afatit për zbatimin e marrëveshjes, mendoj se ka qenë përafërsisht 3 vjet, përkatësisht deri në vitin ..... Ekziston edhe një marrëveshje e dt. ... .., me numër 0.-....., për plotësimin e marrëveshjes së mirëkuptimit, për financimin e projektit QKMF në G., e dt.0..0..2....., me numër 0.-.....

Deklarata e dëshmitarit S.K, i cili ka deklaruar se në kohën kur është lidhur kontrata për ndërtimin e QKMF-së në G. me A.K – K.G dhe OE “Ariani- Co”, unë kam qenë menaxher i zyrës së prokurimit, e këtë detyrë e kam ushtruar deri në fund të dhjetorit të vitit ..... Se kush ka qenë menaxher i projektit, tani nuk më kujtohet saktësisht por e di se kanë qenë dy ose tre (S.K). Derisa isha menaxher i zyrës së prokurimit ka filluar ndërtimi i QKMF-së, por që në fillim ka qenë një problem lidhur me kanalizimin në lokacionin ku ka qenë dashur që të vendoset objekti

i QKMF-së, por që më pas është tejkualuar dhe është kryer nga K.G e më pas ka filluar ndërtimi. Kontrata ka qenë e lidhur për 578 ditë pune, derisa vlera ka qenë 1..... .. euro. Komuna është dashur ta njoftoj M.SH për situacionet e realizuara e më pas mbi bazën e këtyre punëve të kryera MSH ka bërë realizimin e pagesave. Për periudhën kohore sa isha menaxher i prokurimit nuk ka pasur kërkesa shtesë, pasi që ishin realizuar vetëm punimet e vrazhda. Pos kontratës bazë unë nuk kam marrë pjesë në nënshkrimin e aneks kontratës, e as në kontratat tjera lidhur me këtë projekt. Sipas Ligjit të Prokurimit, arsyet për shkëputjen e kontratës në mes të AK dhe OE-së, janë disa si: nëse OE nuk i përmbahet kontratës sipas planit dinamik, duke mos i kryer punët me kohë dhe në mënyrë cilësore dhe vije deri te shkëputja e kontratës në mënyrë të njëanshme nga AK dhe i shqiptohet dënim OE për mos përmbushje të kontratës të paraparë sipas Ligjit për Prokurim Publik dhe i konfiskohet sigurimi i tenderit. Po ashtu ka mundësi të shkëputet kontrata kur AK është fajtor, e që OE nuk mund ta realizojë projektin si p.sh. Mos kryerja e procedurës së shpronësimit, ose si në rastin konkret mos zgjidhja e problemit të kanalizimit. Se kush ka qenë fajtor në rastin konkret unë nuk e di, por se kontrata është shkëputur me pëlqimin e dyanshëm dhe se unë nuk kam informacion se cilat kanë qenë arsyet për shkëputjen e kontratës. Sa i përket sigurimit të tenderit, e di që ka pasur një sigurim por në çfarë lartësie nuk e di dhe një sigurim i tillë bëhet në mënyrë që nëse OE nuk i kryen punimet, konfiskohet vlera e sigurimit. Sa i përket penalizimeve, menaxheri i projektit e njofton menaxherin e zyrës së prokurimit, e që ky më pas ndërmer masa ndaj OE, por që në rastin konkret a është bërë konfiskimi i sigurimit a po janë shqiptuar penalizime, unë nuk e di, ngase atë kohë unë isha i pezulluar nga puna.

Deklarata e dëshmitarit S.A, i cili ka deklaruar se: unë si menaxher i kontratës nuk kam pasur asnjë angazhim, as me rastin e shkëputjes së kontratës e as me lidhjen e aneks kontratës. Dua të shtoj se përmes E-mailit me dt.... .., iu kam drejtuar MSH-së se sipas organit mbikëqyrës M.I, kompania nuk është interesuar që të i vazhdojë punimet. Kam kërkuar që kompania t' i paraqesë arsyet pse dëshiron ta shkëpus kontratën, por që të njëjtit nuk janë përgjigjur lidhur me arsyet e kërkesës për shkëputje të kontratës. Se a kam pasur të drejtë si menaxher i kontratës të takohem me OE, nuk e di, por konsideroj se nuk ka pasur nevojë për një takim të tillë, ngase i kam besuar ekspertit-organit mbikëqyrës M.I. Si menaxher i kontratës kam dal në vend të ngjarjes dhe raportin dy javor për punët e kryera ia kam përcjell MSH-së. Në cilësi të menaxherit të kontratës jam caktuar me vendimin e kryetarit të komunës. Dua të shtoj se unë me profesion jam ekonomist, e jo ekspert i ndërtimtarisë dhe kam menduar se si menaxher i kontratës kompetencat e mia janë në procedurën e pagesës për punët e kryera. Konsideroj se unë i kam përmbushur detyrat për të cilat jam caktuar, derisa sa i përket policës së sigurimit, unë në pozitën e menaxherit



të kontratës jam caktuar pasi që polica e sigurimit ishte e skaduar. Para meje menaxher i kontratës ka qenë I.K, por pasi që i njëjti është caktuar në një vend tjetër të punës, më është kërkuar mua që të vazhdoj në cilësi të menaxherit të kontratës.

Deklarata e dëshmitarit B.K, i cili ka deklaruar se: Ne si kompani e ndërtimit që në start kemi pasur probleme edhe atë: gypi i kanalizimit, disa konstruksione të betonit, përkatësisht themele të mëhershme, e të cilat ne si kompani kemi qenë në pamundësi për t'i vërejtur, e siç duket as AK- K.G nuk ka pasur njohuri për ekzistimin e tyre, pasi që aty ka qenë sipërfaqe e rrafshët. Më pas ne si kompani kemi hapur themelet, është vendosë gurë themeli, më pas inspeksioni i ndërtimit ka dalë në terren dhe i ka ndërprerë punimet për shkak të lejes së ndërtimit. Ne si kompani nuk e kishim lejen e ndërtimit, pasi që lejen e ndërtimit ka qenë dashur ta sigurojë investitori. Më pas është rregulluar çështja e lejes përmes komunikimit me komunës dhe inspeksionit. Unë kam pasur që të filloj punimet me datë 0..0.. .., por punimet kanë filluar pas nja dy muaj e gjysmë, pasi që është vonuar nënshkrimi i kontratës, por që nga ana jonë gjithçka ka qenë në rregullt, e duke ofruar edhe garancionin, e pse është vonuar nënshkrimi i kontratës unë nuk e di. Pas nënshkrimit të kontratës realizimi i projektit për shkak të pengesave në terren është shtyrë, e që ne zakonisht kemi bërë shkresa komunës, dhe më pas janë evituar pengesat, ashtu që është vazhduar me hedhjen e pllakës së betonit dhe lidhur me punimet e realizuara kam mbajtur ditar pune, pasi që pagesa e situacioneve bëhet duke u kompletuar dokumentacioni dhe me ditar pune. Unë kam bërë sigurimin e kontratës, edhe atë 10 % të kontratës bazë, e cila ka qenë e afatizuar për 18 muaj nga dita e nënshkrimit, e përkatësisht deri në vitin 2018, ndërsa unë punimet e vrazhda i kam përfunduar me dt.19.11.2018. Arsyeja pse unë kisha kërkuar shkëputjen e kontratës ka qenë afati i tejkaluar për realizimin e punimeve, e po ashtu edhe mungesa e mjeteve buxhetore, e që ministria ka deklaruar se mjetet do të sigurohen, ashtu që të gjitha situacionet për punët e kryera më janë paguar por me vonesë. Vlera e pagesës që më është bërë është diku 40% e vlerës së kontratës, e askush nga AK nuk ka kërkuar vazhdimin e policës së sigurimit, pasi që të njëjtës i kishte skaduar afati. Lidhur me punët e papërfunduara përsëri është shpallur tender, por që unë nuk kam qenë i interesuar të aplikoj, ashtu që me rastin e shkëputjes së kontratës tekstin e kërkesës e kam përpiluar unë, ndërsa marrëveshjen për shkëputje e ka përpiluar komuna, të cilën e kam nënshkruar unë dhe tani i akuzuari I.K. Unë kontratën për kryerjen e punimeve e kam nënshkruar për realizimin komplet të projektit, e jo vetëm për punët e vrazhda, ndërsa mos realizimi me kohë i kontratës ka qenë me lëshimet ekskluzive të AK, përkatësisht Komunës së Gjilanit dhe MSH.

Deklarata e dëshmitarit A.A., i cili ka deklaruar se: Lidhur me kontratën për të cilën tani bëhet fjalë, unë kam qenë udhëheqës i divizionit të infrastrukturës në MSH, ndërsa në raport me projektin jam autorizuar nga ministria për monitorimin e realizimit të projektit. Projekti i QKMF-së në Gj., ka qenë rezultat i memorandumit të mirëkuptimit në mes të MSH-së dhe Komunës së Gj. Unë jam emëruar monitorues në këtë rast, diku në fillim të Dhjetorit të vitit 2016. Arsyeja pse është vonuar fillimi i punimeve unë saktë nuk e di, por në bazë të komunikimeve verbale që kishim me zyrtarët e komunës, ka pasur probleme me një gyp të kanalizimit apo ujësjellësit, por njoftim formal nuk kemi pasur. Projekti ka pasur menaxher por edhe kompani të kontraktuar për mbikëqyrje. Pasi që situacioni i parë nuk ishte paguar për shkak të mos kryerjes së punimeve, dhe mos plotësimit të duhur të dokumentacionit, unë kam kërkuar që dokumentacioni të plotësohet dhe pasi që është kompletuar është bërë pagesa brenda dy javëve në vlerën prej 100.000 euro. Sa i përket situacioneve nuk ka pasur problem për realizimin e pagesave, pasi që ministria e ka pasur buxhetin e siguruar. Vlera e mjeteve të paguara për situacionet e kryera ka qenë diku mbi 400.000 euro. Lidhur me rastin konkret sa i përket policës së sigurimit, kompetencë për përcjelljen e saj ka qenë menaxheri i projektit, e që i njëjti ka qenë dashur ta njoftojë zyrën e prokurimit për skadimin e policës së sigurimit dhe nevojën për ri përtëritje. Sa i përket marrëveshjes miqësore për shkëputjen e kontratës në mes të Komunës së Gjilanit dhe Operatorit Ekonomik, ne në fillim nuk kemi pasur njohuri, por jemi njoftuar më pas pasi që është bërë marrëveshja për shkëputje dhe se nga ne si ministri nuk është kërkuar ndonjë parapëlqim, ashtu që unë kam ardhur në Komunën e Gjilanit për të parë se çka po ndodhë me kontratën. Unë kërkoja nga AK garancionin, por në këtë rast kam vërejtur se afati i garancionit kishte qenë i skaduar. Me sa më kujtohet koha e realizimit të këtij projekti ka qenë 3 vjeçare, ndërsa unë si monitorues në këtë rast kam qenë deri në vitin 2020, për shkak të angazhimeve më pas unë jam zëvendësuar. Më pas Ministria ka vendosur që të vazhdoj realizimin e projektit, përkundër faktit që AK kishte shkëputur kontratën me OE dhe është bërë përsëritja e memorandumit mes Komunës së Gjilanit dhe MSH në vitin 2019. Sipas meje operatori ekonomik nuk ka pasur ndonjë arsye ta shkëpusë kontratën dhe së kontrata bazë ka qenë 1.190.000 euro, ndërsa kontrata e dytë për punët finale mbi 1.400.000 euro.

Deklarata e ekspertit R.B., i cili ka deklaruar se: Ekspertizën e dt.25.07.2022, e kam përpiluar pas analizimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit bashkëngjitur shkresave të lëndës dhe kam paraqitur mendimin dhe konstatimin tim. Sa i përket garancionit është paraparë me dispozita ligjore dhe me kontratë për kryerjen e punimeve e që sigurimi do të ndalet nga AK për mos realizimin e plotë të obligimeve kontraktore nga ana e operatorit. Polica e sigurimit ka qenë e

lëshuar me dt.03.11.2016 dhe ka qenë e vlefshme deri me dt.02.06.2018, në vlerë prej 119.543.86 euro, përkatësisht 10 % e vlerës së projektit, ndërsa shkëputja e kontratës është bërë me dt.12.07.2019, e që periudha prej 13 muajve ka qenë e pambuluar me policë të sigurimit. Pas përfundimit të policës së sigurimit, zyra e prokurimit publik ka qenë dashur të bëjë kërkesë për vazhdimin e policës së sigurimit, por nuk ka pasur kërkesë derisa afati i kontratës ka qenë 578 ditë pune, e në ditë kalendarike konvertuar bëjnë 809 ditë.

Sa i përket plotësim ekspertizës eksperti ka deklaruar se sa i përket pikës B të konstatimit, ku janë parashtruar pyetjet-detyrat, në faqen 20, 21 dhe 23, ku është theksuar se komisioni e ka bërë vlerësimin e punëve të kryera sipas kontratës, ka konstatuar se vlera e punimeve për rindërtimin përfundimtar të punimeve të QKMF-së, është caktuar të jetë në shumën prej 1.429.466,81 euro, ashtu që kam ardhur në përfundim se mjetet të cilat janë paguar për kryerjen e pjesës së punimeve deri në ndërprerjen e kontratës janë arsytuar si të tilla. Andaj, nga kjo rezulton që palët të cilat do ta financonin projektin nuk kanë pësuar dëm. Sa i përket realizimit të kontratës deri në shkëputjen e saj gjithçka ka qenë në rregull, e që unë jam bazuar në vlerësimin e Komisionit Vlerësues, ashtu që të njëjtit kanë propozuar që të bëhet ri tenderimi. Se a është përfunduar projekti sipas vlerës së kontratës unë nuk kam njohuri për këtë. Pra, deri në shkëputjen e kontratës nuk ka pësuar dëm askush, derisa pas shkëputjes së kontratës ka rrjedhë një marrëveshje e re mirëkuptimi. Po ashtu vlen të theksohet se më është ofruar një provë nga MSH lidhur me dëmin e pretenduar, e që e kam theksuar në faqen 2 të plotësimit, përndryshe është një raport – analizë e komisionit të ministrisë, por i cili për mua nuk konsideroj se është provë për ta mbështetur mendimin tim profesional.

Deklarata e ekspertit të prokurimit I.P., i cili ka deklaruar se: mbetem pranë ekspertizës së hartuar me datë 19.01.2024, të hartuar sipas urdhëresës së gjykatës, e në të cilën urdhëresë janë përcaktuar detyrat e ekspertit që kanë të bëjnë lidhur me mundësinë e shkëputjes së kontratës me mirëkuptim, kushtet të cilat duhet të përmbushen për shkëputje si dhe në rastin konkret a ka qenë dashur të merret pëlqimi nga MSH si investitor me 85% të investimeve. Unë si ekspert i prokurimit konstatoj se kohëzgjatja e kontratës të datës 03.11.2016, ka qenë për një periudhë jo më tepër se 578 ditë pune, ashtu që marrëveshja për shkëputjen e kontratës është bërë me datë 12.07.2019, gjegjësisht pas skadimit të afatit të kontratës. Sipas Ligjit të prokurimit nuk rregullon kushtet për shkëputjen e kontratës, mirëpo shkëputja e kontratës parashihet në kushtet e përgjithshme të saj. Sa i përket zbatimit të policës së sigurimit në ekspertizë kam sqaruar se I.K me vendimin nr.533, të datës 17.06.2018, është caktuar udhëheqës i Zyrës së prokurimit pas

skadimit të afatit të policës së sigurimit. Po ashtu në ekspertizë kam konstatuar se zyrtari përgjegjës i prokurimit nuk ka dëshmuar se ka kërkuar vazhdimin e sigurimit. Konfiskimi i sigurimit bëhet vetëm në rastet kur kryesi i punëve është përgjegjës për mos zbatimin e kontratës konform kushteve të kontratës, kur dëshmohet që OE ka neglizhuar punën dhe nuk ka arritur të i përfundoj punët sipas kontratës, e që në rastin konkret nuk konstatohet se punëkryesi ka qenë përgjegjës për mos zbatimin e kontratës me kohë. Në rastin konkret nuk kemi asnjë provë se Komuna e Gj. i është drejtuar OE, se i njëjti ka rënë në vonesë në realizimin e punimeve të parapara sipas planit dinamik. Çmimet nuk kanë mundur të ndryshohen, ngase nuk ka qenë e paraparë që në tender dhe rrjedhimisht operatori ka hequr dorë nga vazhdimi i kontratës. Kontratën bazë nuk e ka nënshkruar MSH, por e ka nënshkruar AK- Komuna e Gj., ngase në marrëveshjen e mirëkuptimit i janë bartur kompetencat Komunës së Gj. për udhëheqjen e procedurës tenderuese. Sa i përket faktit se a ka qenë dashur të merret pëlqimi për shkëputjen e kontratës nga MSH, konstatoj se përgjegjës për iniciimin e procedurës së prokurimit, lidhjes së kontratës dhe ndërprerjes së kontratës është Komuna e Gj., ngase ashtu janë marrë vesh palët, me rastin e memorandumit të mirëkuptimit, e që Komuna e Gj. ka qenë dashur të i realizoj detyrat e prokurimit. Shkëputja e kontratës është bërë konform nenit 26, mbi kushtet e përgjithshme të kontratës, duke e pasur parasysh se afati i zbatimit të kontratës kishte skaduar.

Deklarata e të akuzuarit I.K ku i njëjti ka deklaruar se me rastin e nënshkrimit të kontratës për QKMF në Gj., unë kam qenë menaxher i projektit, derisa nënshkruesi i kontratës në mes të autoritetit kontraktues i Komunës së Gj. dhe Operatorit Ekonomik “A. CO”, ka qenë S.K., i cili me atë rast ka qenë zyrtar përgjegjës i prokurimit publik. Ushtrues detyre - udhëheqës i zyrës së prokurimit publik, unë jam emëruar me datë 13.06.2018. Në rastin konkret gjatë realizimit të projektit AK, ka pasur të kontraktuar një kompani profesionale për mbikëqytjen e projektit lidhur me cilësinë e punimeve, sasinë e punimeve, nënshkrimin e ditarëve, librin ndërtimor, derisa unë si menaxher i projektit kam kontrolluar dhe mbikëqyr kompani mbikëqyrëse a është duke i përcjell realizimin e punimeve, nënshkrimin e ditarëve, sigurimin e punishtes, dhe kam bërë raport zyrtarit kryesor administrativ për punimet e realizuara. Si menaxher i projektit e kam ditur se validiteti i realizimit të punimeve është 578 ditë pune dhe kontrata sipas planit dinamik ka përfunduar me dt.02.06.2018. në momentin kur jam zgjedhur ushtrues detyre i zyrtarit përgjegjës të prokurimit publik, në atë kohë menaxher i kontratës është caktuar S.A. Në cilësi të zyrtarit përgjegjës të prokurimit publik nga OE, më është bërë kërkesë për shkëputjen e kontratës dhe në atë kohë me rastin e mbajtjes së takimeve kontrata ka qenë e skaduar. Takimet janë mbajtur pasi që insistimi ynë ka qenë që të ripërtërihet kontrata dhe të vazhdojnë punimet por OE ka kërkuar

që të bëhet korrigjimi i çmimeve për shkak të kohës tre vjeçare të lidhjes së kontratës, por që unë kam refuzuar, pasi që nuk është e lejuar për asnjë pozicion të kontraktuar ngritja e çmimeve. Në pozicionin e ushtruesit të detyrës së menaxherit të prokurimit publik kam pasur të drejtë për shkëputjen e kontratës. Ajo kontratë sikurse edhe kontratat tjera të lidhura nga AK kanë policë të ekzekutimit, e që sipas Ligjit të Prokurimit publik nuk thuhet që duhet të kërkohet vazhdimi i policës së sigurimit nga OE. Rëndësia e policës së sigurimit, është që të sigurohet AK, që gjatë ekzekutimit të punimeve mos të ketë vonesa. Në rastin konkret arsyeja pse OE ka kërkuar shkëputjen e kontratës, ka qenë mos sigurimi i vend punishtes nga AK, si dhe vonesa për pagesa që sekretari i MSH ka deklaruar që në fillim ka pasur vonesa në realizimin e pagesave. Në momentin kur është bërë kërkesa për shkëputje të kontratës nga ana e OE afati ka qenë i skaduar, ashtu që ka mundur OE të mos bëjë kërkesë fare, ngase kontrata ka qenë pa afat dhe për këtë fakt në rastin konkret nuk kemi mundur ta bëjmë ekzekutimin e policës së sigurimit, pasi që ajo ka qenë e pa afatshme, pasi që Ligji i prokurimit Publik në nenin 63 nuk e bën askënd përgjegjës për vazhdimin e policës së sigurimit. Me profesion unë jam inxhinier i komunikacionit, e jo i ndërtimtarisë, çka do të thotë që nuk kam qenë adekuat për mbikëqyrjen e punimeve, por duke qenë se ka pasur një kompani mbikëqyrëse të punimeve unë kam pranuar që të jem menaxher i kontratës. Në këtë cilësi unë kam ditur që ka pasur vështirësi në realizimin e punimeve, edhe atë problemi kryesor ka qenë gypi kryesor i kanalizimit i kësaj pjese të qytetit, dhe kemi bërë kërkesë që njësia kërkuese të i eliminojë këto pengesa. Pengesë tjetër ka qenë edhe kablllo elektrik nëntokësor, e po ashtu edhe një themel- bazë betoni, e të gjitha këto kanë qenë të paparashikuara, e që këto pengesa janë evituar nga një kompani tjetër, e cila është kompensuar për këto punë. Edhe sa i përket kontratës së dytë, procedura ka qenë e hapur, ku pjesëmarrës kanë qenë edhe nga MSH, e që tri kompani kanë marrë pjesë në tender, me sa më kujtohet fitues ka qenë një kompani tjetër, ndërsa çmimi i kontratës së parë dhe të dytë nuk më kujtohet. Shkëputjen e kontratës unë e kam nënshkruar në cilësinë e personit përgjegjës së zyrës së Prokurimit Publik dhe lidhur me shkëputjen e kontratës e kam njoftuar ZKA (kryetarin e Komunës). Theksoj se financuesi i projektit me 85% kanë qenë MSH, derisa pjesën tjetër prej 15 % ka pasur për obligim me e siguruar AK- Komuna e Gj., dhe sa i përket shkëputjes së kontratës nuk kemi pasur obligim me e njoftua MSH, pasi që AK dhe MSH nuk kanë qenë palë kontraktuese, por megjithatë ne ju kemi drejtuar MSH-së për kërkesën për shkëputjes së kontratës.

Gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar është vërtetuar edhe me provat materiale si: Njoftimi - kërkesa për autorizim, me numër DHKEK-621/2021, i datës 09 Qershor 2021; Kërkesa DHKEK+621/2019, e datës 22 Qershor 2021; Autorizimi me numër

Sek.nr.15/2021, i lëshuar nga ana e Prokurorisë, me datë 21 Qershor 2021; Raporti për punimet e realizuara dhe njoftimi i shkëputjes së kontratës me operatorin ekonomik, me numër 04-016.01—0096100/19, i datës 22 Korrik 2019; Marrëveshja për shkëputjen e kontratës, ndërmjet Komunës së Gjilanit dhe Operatorit Ekonomik N.N.P.”A.-Co”, e datës 12 Korrik 2022; Raporti “Ndërtimi i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare”, me nr.1/19, e datës 19 Korrik 2018; Paramasa dhe para llogaria e punimeve ndërtimore “Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare”; Plotësim ndryshimi i Marrëveshjes së Mirëkuptimit për Financim i Projektit “Ndërtimi i QKMF në Gj.”, nr.05-4108, i datës 11 Korrik 2016; Marrëveshje e mirëkuptimit për financimin e projektit “Ndërtimi i QKMF” në Gj., e datës 08 Korrik 2016; Procesverbali nga takimi, lidhur me rrjedhën dhe problemet e projektit “Ndërtimi i QKMF Gjilan”, i datës 13 Qershor 2018; Draft kontrata, ndërmjet Komunës së Gj. dhe N.N.P “A.-Co”, Ndërtimi i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, me numër identifikues GI 651 16 044 511, e datës 03 Nëntor 2016; Pjesa II e Kontratës - kushtet e Përgjithshme; Pjesa e III e Kontratës – kushtet e veçanta, paramasa dhe para llogaria e punëve ndërtimore; Formular për dorëzimin e tenderëve, e datës 11 Korrik 2016; Raporti i vlerësimit të tenderëve, e datës 09 Shtator 2016, me numër prokurimit GI651 16 044 511; Përgjigjja në kërkesën sipas nr. ref DHKEK-621/2019, e datës 05 Korrik 2021; Vendimi me numër 16/89972, i datës 29 Korrik 2019, nga zyra e Kryetarit, për emërimin e komisionit për vlerësimin teknik dhe financiar i prerjes së punimeve dhe vlerësimi i pjesës së mbetur deri në realizimin e projektit; Procesverbali i komisionit për pranim teknik dhe llogarisë përfundimtare, i datës 14 Gusht 2019; Korrigjimi i përmasës për instalimet makinerie, e datës 08 Gusht 2019; Marrëveshja për shkëputjen e kontratës për punë, me titullin “Ndërtimi i Qendrës së Mjekësisë Familjare” Gj., e datës 12 Korrik 2019; Autorizimi i kompanisë N.N.P.”A.-Co” i datës 11 Korrik 2019; Procesverbali lidhur me aktivitetin: Ndërtimi i Qendrës së Mjekësisë Familjare në Gj.” i datës 08 Korrik 2019; Kërkesa nga “ kompania N.N.P.”A.-Co”, i datës 26 Prill 2019; Raportet nga organi mbikëqyrës, nr.1/19, 19, 21, 14, 15, 5, 16, 17; Oferta nga Operatori Ekonomik; Ekspertiza financiare, e datës 25 Korrik 2022; Njoftim i dt.25.04.2019 nga S.A. për A.A dhe kopje për: S.Xh. dhe I.K; Plotësim i ekspertizës financiare e dt. 30.10.2023; Ekspertiza e prokurimit, e ekspertit I.P., e dt.19.01.2024.

Gjykata e shkallës së parë, ka bërë analizën e të gjitha provave të propozuara nga palët e të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me këto prova ka paraqitur konkludimet e veta, duke ardhur në përfundim se nga provat e administruara nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale që i vihet në barrë, respektivisht nga provat e administruara nuk kanë mund të vërtetohen elementet e kësaj vepre penale, përkatësisht nuk ishte mundur të provohej se i

akuzuari në cilësi të personit zyrtar duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, me dashje apo dijeni bën shkeljen e ligjit lidhur me detyrat e me qëllim që vetit ose tjetrit të i sjell përfitim të kundërligjshëm pasuror ose të dëmtoj personin tjetër, me rastin e shkëputjes së kontratës, ashtu si pretendohet në akuzë për veprimet e të akuzuarit.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës vlerëson si të drejta përfundimet e gjykatës së shkallës së parë duke qenë se nga provat e administruara e rrjedhimisht edhe nga ekspertiza e ekspertit financiar dhe plotësimi i ekspertizës financiare të ekspertit R.B. nga e cila është konstatuar se, po që se projekti do të kishte dështuar, dëmi i shkaktuar do të ishte 542.664.70 euro, *(shuma monetare si dëm për të cilën prokuroria pretendon si në ankesë, por jo që është në përshkrim faktik të akuzës)*, por nëse pas shkëputjes së kontratës është realizuar i njëjti projekt ku janë përfshirë edhe punët e investuara nga palët në marrëveshje, rezulton se asnjëra palë nuk ka pësuar dëm mbi bazën e investimeve të bëra, kjo për faktin se për pjesët e investimeve të paguara janë kryer punimet. Po ashtu nga edhe nga ekspertiza e ekspertit të prokurimit I.P., nga e cila konstatohet se shkëputja e kontratës është bërë konform kushteve të përgjithshme të kontratës, të datës 03.11.2016, përkatësisht shkëputja e kontratës është bërë pas skadimit të periudhës së kontratës për shkak të dështimit të AK - Komunës së Gj. që të përmbush kushtet për realizimin e projektit, konform periudhës së ekzekutimit të kontratës, e që nga kjo ekspertizë është vërtetuar edhe fakti që në bazë të marrëveshjes së mirëkuptimit për ndërtimin e QKMF-së në Gj., të arritur në mes të MSH-së dhe Komunës së Gj., të dt.11.07.2016, AK- Komuna e Gj. nuk ka pasur nevojë të merr pëlqimin e MSH-së për shkëputjen e kontratës ngase procedura tenderuese sipas marrëveshjes i ishte lënë në kompetencë AK - Komunës së Gj.

I akuzuari, I.K, me vendimin e ZKA – Kryetarit të Komunës të datë 21.06.2018 ishte zëvendësuar në cilësi të menaxherit të projektit nga S.A., ngase ishte emëruar ushtrues detyre menaxher i Zyrës së prokurimit. Shkëputjen e kontratës i akuzuari e kishte nënshkruar në cilësi të ushtruesit të detyrës së zyrtarit përgjegjës të prokurimit publik (në kuadër të autorizimeve të tija) dhe se të njëjtën e kishte bërë pas skadimit të afatit të kontratës përkatësisht me datë 12.07.2019. Po ashtu policës i kishte skaduar afati me datë 02.06.2018, pra kontrata ishte e pa mbuluar me policë më tepër se 13 muaj, fakt ky që vërtetohet nga prova materiale të sipërtheksuara. Me asnjë provë nuk vërtetohet se i akuzuari I.K të kishte përfituar në mënyrë të kundërligjshme me rastin e shkëputjes së kontratës dhe se projekti i QKMF-së më pas kishte përfunduar.

Andaj, në rastin konkret, si me të drejtë kishte ardhur në përfundim edhe gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar, nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë që në veprimet e të akuzuarit të jenë përmbushur elementet e veprës penale Keqpërdorimi i detyrës apo autoritetit zyrtar e paraparë në nenin 414 par.3 nën par.3.1, lidhur me par.1. të KPRK-ës, pasi që me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari në cilësi të personit zyrtar duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, me dashje apo dijeni bënë shkeljen e ligjit lidhur me detyrat apo punësimin e zyrtarit, me qëllim që vetit ose tjetrit të i sjellë përfitim të kundërligjshëm pasuror, ose të dëmtoj personin tjetër, me rastin e shkëputjes së kontratës, e cila kontratë ishte shkëputur pas skadimit të kohëzgjatjes së paraparë, e po ashtu sa i përket policës së sigurimit të njëjtës i kishte skaduar afati para se kontrata të shkëputet.

Gjykata e Apelit rikujton se vepra penale Keqpërdorim i detyrës zyrtare apo autoritetit zyrtar nga neni 414 të KPK-së, si veprim kryerës përcakton në mënyrë alternative dhe atë: shfrytëzimi i pozitës zyrtare apo autorizimeve, tejkalimin e autorizimeve apo mos përmbushja e detyrave zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj për vete ose për tjetrin për të siguruar/realizuar çfarëdo përfitimi, shkaktimi të dëmit personit tjetër ose që seriozisht ti shkel të drejtat e personit tjetër, ndërsa për nga forma e fajësisë kryhet vetëm me dashje direkte.

Në anën tjetër, në këtë çështje penale edhe pse në përshkrim faktik të akuzës veprimi kryerës që pretendohet se i akuzuari kishte ndërmarrë ishte që me **qëllim të përfitimit të çfarëdo dobie për vete apo personin tjetër apo t'i shkaktoj dëm personit tjetër** duke i tejkaluar autorizimet (dhe pse nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor ishte vërtetuar se i akuzuari veprimet i kishte ndërmarrë në kuadër të kompetencave të tij ligjore - ud. Drejtor i Prokurimit në K. të Gj., pra jo si ka pretenduar akuza se i pandehuri ka tejkaluar kompetencat) ndërsa me asnjë provë prokuroria nuk kishte dëshmuar për të vërtetuar dhe ndërlidhur dashjen për qëllimin e përfitimit apo të shkaktimit të dëmit, si element subjektiv të kësaj vepre penale, pra se i pandehuri me veprimet e tij kishte për qëllim për të përfituar për vete apo për personin tjetër çfarëdo dobie apo për qëllimet e shkaktimit të dëmit personit tjetër.

Në këtë rast, si pretendon prokuroria në ankesë, në pjesën e ri tenderuar për punët e mbetura të pakryera sipas kontratës të skaduar, është rritur vlera për 542.664.71 € për të cilën prokuroria pretendon se është kjo shumë e dëmit që i është shkaktuar MSH dhe Komunës së Gj., përkundër kësaj nga provat e administruara rrjedh se në këtë çështje penale palët të referuar si të dëmtuara në këtë rast ishin dakorduar sipas marrëveshjes për të finalizuar punët e mbetura me të njëjtin



operator duke marrë për bazë vlerësimet e komisionit për pranim teknik dhe llogari përfundimtare sipas projektit me nr. të prokurimit GI 651 16 044 511, (ngase ashtu si rezulton nga shkresat e lëndës rrjedh se vet pala e dëmtuar, Komuna e Gj., për shkak të obligimit për eliminim të pengesave në vend punim të paparashikuara, e kishin OE vonuar për të realizuar punimet sipas dinamikës së kontratës së skaduar ) prandaj, nuk rezulton i vërtetuar me asnjë provë qëllimi apo dashja e të pandehurit I.KK për përfitim apo dëmtim të personit tjetër, e me këto veprime për të kryer veprën penale për të cilën është akuzuar me aktakuzë të prokurorisë.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS]**  
**Departamenti i Krimeve të Rënda**  
**PAKR.nr.223/2024, datë 19.04.2024**

**Bashkëpunëtore Profesionale,**

**Kryetare e kolegjit,**

\_\_\_\_\_

**Gresë Latifi**

\_\_\_\_\_

**Afërdita Bytyçi**

**Vaton Durguti**

\_\_\_\_\_

**Skender Çoçaj**